



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

*Udhëzues për planifikim dhe raportim
të punës së edukatoreve, mësuesve
mbështetës si dhe asistentëve*





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology

*Udhëzues për planifikim dhe raportim
të punës së edukatoreve, mësuesve
mbështetës si dhe asistentëve*

*Ky material u dedikohet të gjitha Drejtorive Komunale të Arsimit
dhe të gjitha institucioneve edukative dhe arsimore
në Republikën e Kosovës.*

Përmbajtja

Hyrje.....	4
Rëndësia e shërbimeve mbështetëse.....	6
Përgjegjësitë e mësimitdhënësit/es mbështetës në shkollë.....	9
Përgjegjësitë e edukatorit-es mbështetës në institucionet parashkollore	11
Përgjegjësitë e asistentit-es për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.....	13
Plani javor i punës së mësimitdhënësit mbështetës.....	16
Raporti javor i punës së mësimitdhënësit mbështetës.....	17
Plani mujor i punës së mësimitdhënësit mbështetës.....	18
Raporti mujor i punës së mësimitdhënësit mbështetës.....	19
Forma e Raportit të Mësimitdhënësit Mbështetës për Drejtorinë Komunale të Arsimit.....	20
Plani javor i punës së edukatores mbështetëse.....	24
Raporti javor i punës së edukatores mbështetëse.....	25
Plani mujor i punës së edukatores mbështetëse	26
Raporti mujor i punës së edukatores mbështetëse.....	27
Plani javor i punës së Asistentit për fëmijë me nevoja të veçanta	28
Raporti javor i punës së asistentit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore	29
Plani mujor i asistentit për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta.....	30
Raporti mujor i asistentit për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.....	31
Deklaratë e prindit/kujdestarit të fëmijës/nxënësit.....	32

Hyrje

Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim.
Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës. Neni 3.
“Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar”.



Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është një sfidë për të gjitha vendet që synojnë të realizojnë parimin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët pa dallim feje, kulture, race, gjinie e diversiteti e që është e drejtë themelore e çdo njeriu. Në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme,

gjithëpërfshirja është bërë tashmë një realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta. Me këtë problematikë po ballafaqohet edhe Kosova, e cila po bën përpjekje në drejtim të realizimit të konceptit të arsimit gjithëpërfshirës.

Gjithëpërfshirja ka si qëllim që të luftoj përjashtimin dhe diskriminimin dhe të promovoj barazinë në arsim. Me pranimin e të gjithë fëmijëve pa dallime në një shkollë të rregullt sigurohet dhe promovohet barazia, solidariteti dhe respekti i ndërsjellë midis nxënësve.

Gjithëpërfshirja nuk nënkupton vetëm pranimin e nxënësve në shkollë, por edhe ofrimin e mbështetjes së nevojshme në baza individuale, gjithnjë sipas nevojave të fëmijëve.

Gjithëpërfshirja në arsim nënkupton që shkolla duhet të ndryshohet dhe t'ju përshtatet fëmijëve, e jo fëmijët t'i përshtaten shkollës. Drejtorët apo udhëheqësit e shkollave duhet të përkujdesen që të bëjnë ndryshimet e nevojshme në shkollat e tyre që të jenë në gjendje të pranojnë nxënës të ndryshëm në shkollat të cilat i menaxhojnë. Këto ndryshime kanë të bëjnë me rregullimet infrastrukturore, ndryshim të qëndrimeve të stafit dhe ndryshimin e praktikave arsimore. Shpesh këto ndryshime nuk kërkojnë shumë mjete financiare, por më tepër kërkojnë ndryshim të qëndrimeve dhe mënyrës së organizimit të shkollës si institucion.

Në Kosovë shpesh gjithëpërfshirja ngatërrohet dhe identifikohet me arsimin special, gjithnjë duke menduar se janë dy gjëra të njëjta, veçse ka ndërrim të terminologjisë. Si e tillë, gjithëpërfshirja mendohet se ka të bëjë me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar, kjo nuk ka të bëjë aspak me realitetin. Gjithëpërfshirja është shumë më tepër se aq, ka të bëjë me të gjithë ata që janë në rrezik për t'u përjashtuar.

Si e tillë gjithëpërfshirja duhet të shihet si proces, e jo si diçka që mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër. Kjo ka si synim ndryshimin e vazhdueshëm të sistemit

arsimor, për ta bërë atë më fleksibil, më të përshtatshëm dhe që ofron mundësi për një larmi të gjerë nxënësish, andaj duhet punuar për ta bërë shkollën apo institucionin arsimor një vend ku nxënësit apo fëmijët ndihen të sigurt, të lumtur dhe anëtarë të dobishëm të atij institucioni, ku ndjejnë se janë duke mësuar, duke u zhvilluar dhe duke dhënë kontributin e tyre.

Duke marrë gjithsesi në konsideratë edhe domethënien e përcaktimit nga UNESCO (2001) për arsimin gjithëpërfshirës i cili nënkupton që të gjitha shkollat duhet të pranojnë të gjithë nxënësit pa marrë parasysh gjendjen e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose ndonjë gjendje tjetër. Kjo përfshin fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe fëmijët me talent, fëmijët që punojnë, fëmijët nga viset e larta dhe popullatat nomade, fëmijët e minoriteteve gjuhësore, etnike ose kulturore dhe fëmijët nga viset apo grupet e marginalizuara.

Në procesin e gjithëpërfshirjes duhet të angazhohen të gjithë për ta bërë atë realitet duke filluar nga nivelet e larta qeveritare, DKA-të, shkollat dhe komuniteti në përgjithësi.

Pikërisht për këtë arsye edhe ky material u dedikohet të gjitha Drejtorive Komunale të Arsimit si dhe institucioneve edukative dhe arsimore me qëllim që fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore t'ju ofrohet një përkrahje e duhur institucionale si dhe puna e edukatorëve, mësimeve mbështetës si dhe asistentëve të jetë e dokumentuar.

Me gjithë arritjet e shënuara në disa fusha ende ka shumë aspekte ku duhet të punohet në mënyrë që të sigurohet gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Për të përmbushur një mision të tillë, MASHT ka punuar në drejtim të krijimit të infrastrukturës ligjore, e cila do të mundësojë arsimin e të gjithë fëmijëve dhe sigurimin e një ambienti të hapur ndaj ndryshueshmërisë. Po ashtu, në bashkëpunim me DKA-të dhe organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, janë organizuar trajnime dhe punëtori të ndryshme me mësimeve mbështetës.

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për nxënësit, MASHT që nga viti 2009 në bashkëpunim me disa komuna dhe "Save The Children" fillimisht kanë filluar me punësimin e edukatorëve dhe mësuesve mbështetës, kurse nga viti 2019, MASHT ka përfshirë edhe profilin e asistentëve për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Me gjithë përpjekjet e bëra, ende mbetet shumë për t'u bërë në mënyrë që të arrijmë përmirësimin e situatës së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, gjë e cila duhet të jetë preokupimi i tërë shoqërisë.

Rëndësia e shërbimeve mbështetëse



Edukimi dhe arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore mund të jetë një eksperiencë e dobishme, por edhe sfiduese. Personeli që punon dhe është përgjegjës për edukimin e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta së pari duhet të njohin dhe kuptojnë nevojat e veçanta arsimore të nxënësve, mundësitë dhe potencialet e tyre.

Arsimi gjithëpërfshirës si filozofi arsimore për t'u jetësuar kërkon edhe

mekanizma mbështetës të cilët i ndihmojnë institucionet arsimore në sigurimin e gjithëpërfshirjes.

Në kuadër të kësaj, në Kosovë funksionojnë disa mekanizma të cilët i mbështesin institucionet edukative dhe arsimore në këtë fushë si: mësimdhënësi dhe edukatori mbështetës si dhe asistenti për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Këto profile të mësimdhënësve dhe edukatorëve mbështetës si dhe asistentëve, tani janë aktive në disa institucione parashkollore dhe shkolla të cilët kanë rolin e mbështetjes profesionale dhe asistencës nëpër institucione parashkollore dhe shkolla dhe janë nën kompetencën e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe vetë shkollave, ndërsa roli i MASHT-it është hartimi i politikave dhe monitorimi i tyre në terren.

Mirëpo, aktualisht numri i mësimdhënësve, edukatorëve mbështetës si dhe asistentëve në institucione parashkollore dhe shkollë është i vogël ndërkohë që kërkesat për mbështetje të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dita ditës po shtohen. Po ashtu, në disa komuna, menaxhimi efikas i punës së mësimdhënësve, edukatorëve mbështetës dhe asistentëve mbetet ndër aspektet më sfiduese dhe të rëndësishme në mënyrë që sa më shumë fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore të marrin shërbime cilësore në institucione edukative-arsimore.

Me qëllim që fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore t'iu ofrohet një mbështetje dhe përkrahje e duhur, patjetër se duhet respektuar disa parime si:

- Përfshirja, edukimi dhe arsimimi i çdo fëmije/nxënësi;
- Eliminimi i pengesave të çdo fëmije/nxënësi në aktivitete edukative/arsimore;
- Planifikimi i aktiviteteve dhe mësimnxënies duke marrë parasysh nevojat e secilit fëmijë/ nxënës brenda grup- moshës dhe klasës;
- Edukatorët mbështetëse planifikojnë dhe bashkëpunojnë me edukatorët e tjera dhe me tërë personelin brenda institucionit;
- Mësimdhënësit mbështetës planifikojnë dhe bashkëpunojnë me mësimdhënësit e

tjerë dhe tërë personelin brenda shkollës;

- Institucionet parashkollore dhe shkolla përkrah dhe mbështet ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijë/nxënës.
- Institucionet parashkollore dhe shkollat pranojnë fëmijët/nxënësit e zonës që mbulon.
- Partneritetit në mes të institucioneve edukative/ arsimore dhe komunitetit

Për suksesin e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta, rëndësi të veçantë ka përfshirja adekuate në aktivitetet e grupit.

Nëse nga fillimi i inkurajojmë në bashkëpunim dhe besim të ndërsjellë dhe besim në bashkim të forcave, shoqërisë dhe gëzimit të suksesit për tjetrin, rezultatet nuk do të mungojnë. Ndiheja më e madhe është pranimi social, të kuptuarit dhe marrja në konsideratë pa dhembshuri.

Profilet e mësimdhënësve, edukatorëve mbështetës si dhe asistentëve por duke mos anashkaluar edhe profilet e profesionistëve të tjerë janë të domosdoshme dhe nevojë urgjente e të gjitha institucioneve edukative-arsimore, me qëllim që këta fëmijë të bëjnë jetë të pavarur dhe kualitative.

Duke iu referuar UA24/2014, Shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma të burimeve janë përcaktuar edhe procedurat se kur një mësimdhënës i klasës së bashkangjitur kalon në mësimdhënës mbështetës.

Pas përfundimit të procesit të shndërrimit të klasës së bashkangjitur në dhomë burimore mësimdhënësi i klasës së bashkangjitur kalon në mësimdhënës mbështetës në nivel shkolle.

Rol kyç në këtë proces kanë DKA-të që bazuar në raportet e vlerësimit pedagogjik të fëmijëve/nxënësve nga ekipi vlerësues në nivel komune dhe bazuar në kapacitetet që kanë (numrin e mësuesve mbështetës) brenda komunës të bëjnë planin e menaxhimit/caktimit të mësimdhënësve, edukatorëve mbështetës, dhe asistentëve sipas kërkesave dhe nevojave që janë identifikuar.



Mësimdhënësi mbështetës: ka statusin e njëjtë sikurse të gjithë mësimdhënësit e tjerë brenda një shkolle, por fokusi i punës së tij janë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Mësimdhënësit mbështetës duhet të planifikojnë mësimdhënien, të përdorin metoda dhe teknika të mësimdhënies që ju përshtaten nevojave, talenteve si dhe stileve të ndryshme të të nxënës dhe të mundësojnë që secili nxënës pa marrë parasysh dallimet të jetë i përfshirë në aktivitetet në klasë dhe të përfitoj nga të nxënës.

Eduktor/ja mbështetës/e; është me status të njëjtë sikurse të gjitha edukatorët në institucion parashkollor, por fokusi i tij/saj janë fëmijët me nevoja të veçanta. Ata duhet të krijojnë shprehje dhe të promovojnë barazinë në grupe-moshë/klasë ku secili fëmijë të ndjehet i respektuar dhe çmuar si individ, njëkohësisht duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me tërë stafin e institucionit parashkollor, e në

veçanti me edukatorët e grup- moshave në të cilën është fëmija dhe i ofrohet mbështetje, te edukatorët e para dhe përgjegjëse të fëmijës.

Asistenti: asistenti në klasë në masë të madhe mund të përmirësojë cilësinë e procesit mësimor, duke iu ndihmuar në radhë të parë dhe direkt fëmijëve/nxënësve.

Asistenti përcaktohet në rastet kur ekipi vlerësues pedagogjik komunal vlerëson dhe rekomandon se një fëmijë/nxënës i duhet një mbështetje nga asistenti.

Rol kyç në ofrimin e shërbimeve mbështetëse kanë edhe psikologët dhe pedagogët.

Psikologu: i cili ofron shërbime psikologjike në institucione parashkollore dhe shkolla në përputhje me politikën e zhvillimit të arsimit dhe institucionit edukativ/arsimor i cili fokusohet në promovimin dhe zhvillimin psiko-fizik të fëmijëve/nxënësve si dhe lehtësimin e mësimnxënies. Psikologu bashkëpunon me personelin administrativ dhe pedagogjik për realizimin dhe ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët/nxënësit, po ashtu ofron shërbime këshilluese dhe trajnuese për stafin e institucionit edukativ/ arsimor dhe prindërit.

Pedagogu: përqendrohet në zhvillimin profesional të mësimeve dhe zhvillimin e profileve të nxënësve në bashkëpunim me mësimeve dhe duke përdorur teknika dhe metoda bashkëkohore si dhe është bashkëpunues në hartimin e PIA-së.

Prindërit: janë forca shtytëse për ndryshim pozitiv të shkollës dhe akterë të rëndësishëm në reformën arsimore dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë. Prindërit kanë ndikim edhe tek fëmijët e vegjël se në çfarë mënyre në të ardhmen këta fëmijë do të përshtaten në shkollë. Në qendër të bashkëpunimit mes shkollave dhe prindërve është mirëqenia e fëmijës si dhe shkëmbimi i rregullt dhe i institucionalizuar i informacioneve dhe ideve.

Përgjegjësitë e mësimeve/mbështetës në shkollë

Një shërbim i rëndësishëm së veçantë janë mësimeve mbështetës e që aktualisht numri i tyre në shkollë të rregullta është i vogël, ndërkohë që kërkesat për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dita ditës po shtohen.

Aktualisht në disa komuna ka vështirësi të theksuara dhe mungesë të një organizimi sa më cilësor sa i përket mësimeve mbështetës në nivel shkollë.

Në kuadër të kësaj, roli i DKA-ve/zyrtarëve për arsim gjithëpërfshirës është, që në bazë të raporteve të vlerësimit të fëmijëve nga ekipi vlerësues pedagogjik dhe bazuar në kapacitetet që kanë (numrin e mësimeve mbështetës) brenda komunës, të bëjnë planin e menaxhimit/ shpërndarjes së mësimeve mbështetës sipas kërkesave dhe nevojave që janë identifikuar, në mënyrë që këto shërbime të menaxhohen drejtë dhe në mënyrë efektive ekipet vlerësuese në nivel komune duhet të vlerësojnë sa më drejt nevojat pedagogjike të nxënësve që janë në shkollë, por edhe atyre jashtë shkollë, duke marrë parasysh mundësitë financiare dhe burimet njerëzore në dispozicion.

Kjo mënyrë e funksionimit do të mundësojë që kapacitetet në nivel komune të shfrytëzohen racionalisht dhe po ashtu të identifikohen dhe dokumentohen nevojat për resurse apo kapacitete shtesë që i nevojiten komunës në mënyrë që të planifikohet sipas gjendjes faktike.

Gjatë planifikimit të formës së mbështetjes duhet të merret për bazë edhe raporti mësues mbështetës-nxënës, pasi që një mësues mbështetës mund të përkrahë rreth 8-10 nxënës me PIA dhe të tjerë sipas nevojës në një shkollë apo në disa shkollë kur ky numër është më i vogël se 8 nxënës në një shkollë me planin individual të arsimit (PIA).

Mirëpo, në rastet kur në shkollë nuk ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore që kanë nevojë për mbështetje, atëherë ai mund të kalojë mësimeve mbështetës në shkollë tjera.

Mësimeve mbështetës është përgjegjës për ofrimin e mbështetjes në të gjitha nivelet arsimore brenda institucionit shkollor.

Roli i mësimeve mbështetës është të koordinoj mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore brenda shkollës, të këshillojë dhe bashkëpunoj me menaxhmentin e shkollës dhe mësimeve mbështetës për identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Po ashtu, mësimeve mbështetës në bashkëpunim me kujdestarin e klasës dhe mësimeve mbështetës lëndor koordinon format e mbështetjes për fëmijët me nevoja të veçanta në fushat apo lëndët përkatëse, ndihmon në planifikim, realizim dhe vlerësim të arritjeve të nxënësit. Por, më gjerësisht ja detyrat dhe përgjegjësitë e mësimeve mbështetës:

- ◆ Mësimeve mbështetës janë përgjegjës për mbështetjen e institucionit në sigurimin e përkrahjes së nevojshme për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore,

këshillimin dhe mbështetjen e mësimeve dhe personelit të institucionit.

- ◆ Identifikojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore brenda institucionit shkollor.
- ◆ Pas identifikimit të fëmijës në bashkëpunim me mësimeve klasor/kujdestarin e klasës dhe drejtorin informojnë prindërit/kujdestarët dhe referojnë fëmijën për vlerësim pedagogjik në ekipin komunal.
- ◆ Mbështet nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë në klasa të rregullta.
- ◆ Planifikon dhe organizon bashkë mësimeve me mësimeve në rregull në klasa ku ka nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
- ◆ Kur ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë klasës.
- ◆ Përpilon planin individual të arsimit bashkë me mësimeve në rregull, prindin dhe anëtarët tjerë të ekipit të planit individual të arsimit (PIA) dhe kur është e mundur edhe vetë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore.
- ◆ Përkujdeset që plani individual i arsimit të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë.
- ◆ Këshillon dhe ndihmon mësimeve në rregull se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhoj me klasën gjithëpërfshirëse.
- ◆ Harton dhe ideon materiale mësimore alternative bashkë me mësimeve në rregull të cilat do të përdoren në mësimeve me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
- ◆ Ndihmon në vetëdijësimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes.
- ◆ Ndihmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
- ◆ Bashkëpunon me asistent personal rreth organizimit të mbështetjes së nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollë. Se bashku mund të krijojnë materiale alternative sipas nevojave individuale të nxënësit.
- ◆ Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimeve, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, si dhe në integrimin e tyre në klasa të rregullta.
- ◆ Planifikon në baza javore dhe mujore dhe i raporton drejtorit të shkollës ku punon për punën e bërë.

Një element shumë të rëndësishëm që mësimeve mbështetës duhet të ketë parasysh janë edhe dosjet për secilin fëmijë/nxënësit të cilat duhet të përbëjnë:

- Vendimin për arsim me nevoja të veçanta arsimore;
- Dokumentin e identifikimit nga ekipi vlerësues në nivel komunal;
- Planin individual i arsimit (PIA);
- Fletoret e punës, fleta vizatime punime të ndryshme të cilat realizohen nga ana e mësuesit të klasës dhe mësimeve mbështetës;
- Takimet me prindër;

- Raportin nga psikologu dhe profesionist tjerë në shkollë;
- Raport këshillimi nga ana e mësuesit mbështetës;
- Të tjera sipas nevojës.

Përgatitja shkollore e mësimeve mbështetës bazohet në Legjislacionin aktual në fuqi.

Përgjegjësitë e edukatorit-es mbështetës në institucionet parashkollore



Fëmijëria e hershme 0-6 vjeç, është moshë kur fëmijët zhvillohen më shpejtë se në cilëndo moshë tjetër. Është periudha kur fëmija hulumton (eksploron) ambientin përreth përmes shqisave të prekurit, të pamurit, të shijuarit, të dëgjuarit dhe të nuhaturit, ndërkohë që ngacmimi i këtyre shqisave nxit proceset dhe zhvillimin motorik, kognitiv, të gjuhës dhe komunikimit si dhe shkathtësitë socio-emocionale.

Shumë nga shkathtësitë jetësore themelore, mësohen dhe zhvillohen në tri vitet e para të jetës të cilat mandej shkojnë duke u përsosur si:

- ◆ Shkathtësitë fizike (mbajtja e kokës lart, zgjatja e dorës, manipulimi me objekte të mëdha e të vogla, rrotullimi, ulja, zvarritja, ecja, vrapimi, etj.);
- ◆ Shkathtësitë kognitive-njohëse (të menduarit, të mësuarit, lidhja mes shkakut dhe pasojës, zgjidhja e problemeve etj.);
- ◆ Shkathtësitë e komunikimit dhe gjuha (mimika, gjestikulacionet, të dëgjuarit, të kuptuarit, të folurit, etj.);
- ◆ Shkathtësitë social-emocionale (loja, ndjenja e të qenit i/e sigurt, i/e lumtur, përkatësia në familje e shoqëri, etj.);
- ◆ Shkathtësitë e jetës së përditshme (të ushqyerit, të veshurit, të mbathurit, etj.).

Ofrimi i mbështetjes herët në jetë lidhet me rezultate/arritshmëri më të larta për fëmijët në përgjithësi, familjeve dhe komuniteteve, veçanërisht kur kjo mbështetje ofrohet në ambientet më të afërta të fëmijës, në familje dhe brenda komunitetit ku jeton.

Intervenimi i hershëm nënkupton një sistem të shërbimeve të dizajnuara për t'u ndihmuar fëmijëve me aftësi të kufizuara (nevoja të veçanta) drejtpërdrejt dhe përmes ofrimit të mbështetjes prindërve të tyre.

Andaj edukatori mbështetës ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi:

- ◆ I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit parafillor;
- ◆ Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës edukative dhe arsimore si dhe zhvillon aktivitete të përbashkëta me edukatorët e grup-moshave të ndryshme;
- ◆ Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore sipas grup-moshave;
- ◆ Harton plane individuale për fëmijët me nevoja të veçanta (në bashkëpunim me edukatoren, prindërit apo kujdestarë të fëmijëve, me asistent personal si dhe me stafin profesional të institucionit);
- ◆ Bashkëpunon me ekipin për identifikim dhe vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në nivel komunal;
- ◆ Sipas Ua 24/2014, neni 5 pika 4 sipas nevojës kur është e domosdoshme punon individualisht me fëmijët jashtë grup-moshës;
- ◆ Ndhmon edukatorët në punë me fëmijë me nevoja të veçanta dhe si të menaxhohet puna me tërë grupin;
- ◆ Në bashkëpunim me edukatoren e grupit hartojnë materiale alternative për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;

Edukatori/ja mbështetës po ashtu është përgjegjës edhe për mirëmbajtjen e dosjeve të fëmijëve e cila duhet të përmbajë:

- Vendimin dhe fletëvlerësimin e identifikimit nga ekipi vlerësues në nivel komunal;
 - PIA-në;
 - Fletoret e punës, fleta vizatime punime të ndryshme të cilat realizohen nga ana e edukatorit të grup moshës dhe edukatorit mbështetës;
 - Takimet me prindër;
 - Raportin nga psikologu dhe nga profesionistët e tjerë;
 - Dhe të tjera sipas nevojës.
- Edukatori/ja mbështetëse është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes të gjitha grup-moshat brenda institucionit.
- Numri i fëmijëve që mund t'i mbështesë një edukatore mbështetëse është e përcaktuar me Udhëzim administrativ 19/2016 Përfshirja e Fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë Neni 5 pika 9 i cili potencon se një edukatore mbështetëse mundet t'i mbështesë 3 fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në një grup-moshë.
- Numri i orëve të punës në javë për edukatore mbështetëse duhet të bazohet në UA 19/2016, Përfshirja e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë e që rezulton me 30+10 orë në javë.

Përgatitja shkollore e mësimdhënësit mbështetës bazohet në Legjislacionin aktual në fuqi.

Përgjegjësitë e asistentit-es për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore



Një tjetër shërbim i rëndësishëm është asistenti për fëmijë/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, i cili ka për detyrë që të asistoj dhe kujdeset për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore gjatë procesit edukativ dhe arsimorë çoftë për nevojat fizike, fiziologjike apo edhe ndonjë asistencë tjetër, për të cilën fëmija ka nevojë e që nuk mund t'ia ofroj mësimsdhënësi.

Një nxënës mund të ketë asistent vetëm atëherë kur ekipi vlerësues pedagogjik komunal vendos për këtë duke i marrë për bazë nevojat e fëmijës/nxënësit.

Asistenti përcaktohet në rastet kur :

- ◆ Fëmija/ nxënësi ka aftësi të kufizuara të rënda apo të shumëfishta, të cilët fëmijë/nxënës nuk janë në gjendje të arsimohen në shkolla të rregullta pa mbështetje të asistentit.
- ◆ Fëmija/ nxënësi ka vështirësi të theksuar të pavarësisë, në mobilitet (lëvizshmëri), ushqim dhe në kujdesin e higjienës personale.
- ◆ Fëmijët/ nxënësit që vijnë nga vendbanimet e largëta dhe pamundësia për të marrë shërbimet e nevojshme në territorin ku jeton.
- ◆ Fëmijët/ nxënësit të cilët janë vështirë të menaxhueshëm dhe që paraqesin rrezik për të tjerët.
- ◆ Ata do të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit e vlerave që promovojnë diversitetin në shkolla si dhe faktorë të ndryshëm për të ofruar sigurinë e nxënësve. Ata, gjithashtu do të mësojnë se si të njohin dhe të parandalojnë ngacmimin dhe përjashtimin social.
- ◆ Asistentët duhet të zhvillojnë njohuritë dhe të kuptuarit për të qenë në gjendje për të mbështetur, zhvilluar dhe zbatuar dhe përshtatin stile të ndryshme të mësimnxënies së përshtatshme për nxënësit me nevoja të veçanta.
- ◆ Asistenti për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore duhet t'i mbështesë të gjitha grup- moshat dhe nivelet brenda institucionit.
- ◆ Numri i fëmijëve/nxënësve që mund t'i mbështesë është:1-2 brenda një shkolle.

Përgatitja shkollore e asistentit bazohet në Legjislacionin aktual në fuqi.



Kohëzgjatja e mbështetjes nga asistenti varet edhe nga shkalla e përparimit të fëmijës\ nxënësit dhe vlerësimit që mund t'i bëjë vet shkolla apo ekipi në nivel shkolle i cili harton dhe monitoron zbatimin e Planit individual të Arsimit PIA-së. Kjo mund të jetë një formë e vlerësimit për kohëzgjatjen e mbështetjes\ asistencës

që nxënësi\ja mund të ketë nevojë apo nëse është e nevojshme kërkohet ndihma edhe nga ekipi vlerësues pedagogjik në nivel komunal.



Detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore:

- ◆ Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë.
- ◆ Bashkëpunon me mësime dhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve.
- ◆ Përgatit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- ◆ Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuara të fëmijëve, përgatit informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve.
- ◆ Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve me NV në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës.
- ◆ Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike-fiziologjike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre.
- ◆ Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin.
- ◆ Prezenton punën dhe arritjet e nxënësve. Informacionet në shkollë/institucion i trajton si plotësisht konfidenciale.
- ◆ Përdorë pajisje specifike audiovizuale, teknologjike për të ndihmuar procesin e të nxënësve.
- ◆ Paraqet punën dhe arritjet e nxënësve/ve, plotëson dosjet/ portfoliot e nxënësve/ve.
- ◆ Bashkëpunon me njerëzit profesional në shkollë/institucion si: pedagog, psikolog etj.

Asistentët po ashtu janë edhe përgjegjës për mirëmbajtjen e dosjeve të fëmijëve/nxënësve të cilat duhet të përmbajnë:

- ◆ Vendimin për arsim me nevoja të veçanta arsimore;
- ◆ Dokumentin e identifikimit nga ekipi vlerësues në nivel komunal;
- ◆ PIA-në;
- ◆ Fletoret e punës, fleta vizatime punime të ndryshme të cilat realizohen nga ana e edukatores së rregullt dhe edukatorit mbështetës;
- ◆ Takimet me prindër;
- ◆ Raportin nga psikologu dhe profesionist tjerë në shkollë;
- ◆ Raport këshillimi nga ana e edukatorit mbështetës;
- ◆ Dhe të tjera sipas nevojës.

Plani javor i punës së mësimdhënësit mbështetës

Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit mbështetës _____

Emri i shkollës _____

Viti shkollor _____

Datat:

Ditët	Puna në zyre – Përgatitja e materialeve	Mësimdhënia/bashkë- mësimdhënia në klasa. Lënda- klasa-nxënësi	Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)	Takime me prindër	Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve	Konsulta me mësimdhënës/ mësimdhënës udhëtues të Qendrave Burimore si dhe prindër	Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve	Tjera
E hënë Koha:								
E martë Koha:								
E mërkurë Koha:								
E enjte Koha:								
E premte Koha:								

Raporti javor i punës së mësimdhënësit mbështetës

Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit mbështetës _____

Emri i shkollës _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Aktivitetet e realizuara	Aktivitetet e perealizuara	Vërejtje/Komente
Puna në zyrë – Përgatitja e materialeve			
Mësimdhënia/bashkë- mësimdhënia në klasa. Lënda-klasa- nxënësi			
Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)			
Takime me prindër			
Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve			
Konsulta me mësimdhënës/m. udhëtues të Qendrave			
Burimore si dhe prindër			
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve			
Tjera			

Nënshkrimi i mësimdhënësit mbështetës: _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Plani mujor i punës së mësimdhënësit mbështetës

Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit mbështetës _____

Emri i shkollës _____

Viti shkollor _____

Muaji: _____

Aktivitetet	Java I	Java II	Java III	Java IV	Java V
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve					
Mësimdhënia/bashkë-mësimdhënia në klasa. Lënda-klasa-nxënësi					
Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)					
Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve					
Puna në zyre – përgatitja e materialeve					
Konsulta me mësimdhënës/m. udhëtes të Qendrave Burimore si dhe prindër					
Koordinimi me drejtorin, stafin e shkollës dhe komunitetin për krijimin e kulturës gjithpërfshirëse					
Tjera					

Nënshkrimi i mësimdhënësit mbështetës: _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Raporti mujor i punës së mësimdhënësit mbështetës

Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit mbështetës _____

Emri i shkollës _____

Viti shkollor _____

Muaji: _____

Aktivitetet	Nxënési/orët	Nxënési/orët	Nxënési/orët	Nxënési/orët	Nxënési/orët
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve					
Mësimdhënia/bashkë-mësimdhënia në klasa/bashkëpunimi me mësimdhënës lëndë-klasa-nxënësi					
Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)					
Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve. Puna në zyre – përgatitja e materialeve					
Konsulta me mësimdhënës/m. udhëtues të Qendrave Burimore si dhe prindër					
Koordinimi me drejtorin, stafin e shkollës dhe komunitetin për krijimin e kulturës krijimin e kulturës					
Tjera					

Nënshkrimi i mësimdhënësit mbështetës: _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Forma e Raportit të Mësimdhënësit Mbështetës për Drejtorinë Komunale të Arsimit

Ky raport hartohet nga mësimdhënësi mbështetës dhe përmes drejtorit të shkollës/qendritës duhet të dorëzohet në DKA. Raporti duhet të dorëzohet çdo tre muaj (për tri periudha: shtator-nëntor, janar-mars, prill-qershor), me përjashtim të ndonjë rasti specifik që mund të dorëzohet edhe para tre muajve. Raporti dorëzohet në javën e fundit të përfundimit të periudhës. Në vijim është e pasqyruar struktura e këtij raporti. Po ashtu mësimdhënësi mbështetës këtij raporti mund t'i bashkangjës edhe materiale shtesë, që mendon se janë relevante për raportim.

RAPORT PËRMBLEDHËS

Për: _____
(Emri dhe mbiemri i zyrtarit për gjithëpërfshirje në DKA)

Cc: _____
(Emri dhe mbiemri i drejtorit të arsimit)

Përmes: _____
(Emri dhe mbiemri i drejtorit të shkollës/qendritës)

Nga: _____
(Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit mbështetës)

Lënda: Raport i mbështetjes së ofruar për periudhën _____
(Shënohet periudha p.sh shtator-nëntor 2019)

I/e nderuar _____

Në vijim e keni të pasqyruar raportin përmbledhës për punën profesionale mbështetëse të realizuar nga mësimdhënësi mbështetës në bashkëpunim me të gjithë akterët.

Të dhënat për nxënësit që janë mbështetur				
Nr.	Emri dhe mbiemri ¹	Shkolla ²	Klasa/ paralelja	Emri dhe mbiemri i mësimdhënësit/kujdestarit të klasës

¹ Shënohen vetëm inicialet e emrit dhe mbiemrit të nxënësit, p.sh. A. F.

² Në rastet kur mësimdhënësi mbështetës është i angazhuar në grup shkollash atëherë listohen emrat e të gjithë nxënësve dhe shkollave përkatëse ku ai i mbështetë.

Aspektet kryesore të punës profesionale mbështetëse	
Lëndët/fushat e aktiviteteve ku është ofruar mbështetja ³	
Materialt/ mjetet mësimore që janë krijuar/përdorur ⁴	
Bashkëpunimi me mësuesin në klasë ⁵	
Bashkëpunimi me mësuesin në lëndor ⁶	
Bashkëpunimi me kujdestar klasë ⁷	
Bashkëpunimi me prindër ⁸	
Rezultatet e arritura ⁹	
Sfidat ¹⁰	
Rekomandimet ¹¹	
Të tjera ¹²	
Materialt e bashkëlidhura ¹³	

³ Shënohet mbështetja në formë përmblendhëse p.sh 3 nxënës janë mbështetur në gjuhë, 2 nxënës në matematikë, etj.

Data: _____

Nënshkrimi: _____
(Nënshkrimi i mësuesit mbështetës)

- ⁴ Shënohen materialet që i keni krijuar, materialet që i keni pasur në dispozicion, materialet që ju kanë munguar, etj.
- ⁵ Përshkruhet bashkëpunimi me mësimdhënës klase (klasa përgatitore deri te klasa e pestë) me theks të veçantë vështrirësitë që hasen në bashkëpunim dhe në rastet kur ka rezistencë në bashkëpunim shënohen edhe emrat e mësimdhënësve
- ⁶ Përshkruhet bashkëpunimi me mësimdhënës klase (klasa gjashtë deri te klasa e dymbëdhjetë) me theks të veçantë vështrirësitë që hasen në bashkëpunim dhe në rastet kur ka rezistencë në bashkëpunim shënohen edhe emrat e mësimdhënësve
- ⁷ Përshkruhet bashkëpunimi me kujdestar të klasave të ciklit lëndor (klasa gjashtë deri te klasa e dymbëdhjetë) me theks të veçantë vështrirësitë që hasen në bashkëpunim dhe në rastet kur ka rezistencë në bashkëpunim shënohen edhe emrat e kujdestarëve
- ⁸ Shënohen aspektet kyçe të bashkëpunimit me prindër
- ⁹ Shënohen në formë të përmbledhura rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe
- ¹⁰ Shënohen sfidat/vështirësitë e hasura në ofrimin e mbështetjes
- ¹¹ Shënohen rekomandimet se çfarë duhet të bëhet më tutje. Po ashtu shënohen edhe rekomandimet për mbështetjen që duhet të ofrojë shkolla dhe DKA-ja.
- ¹² Në këtë hapësirë shënohen të gjitha aspektet e tjera që lidhen me mbështetjen e që nuk janë përfshirë në strukturën e raportit.
- ¹³ Shënohen emrat e materialeve të bashkëlidhura nëse ka.

Plani javor i punës së edukatores mbështetëse

Emri dhe mbiemri i edukatores mbështetëse _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Dita	Puna në zyrë – Përgatitja e materialeve	Aktivitetet dhe bashkëaktivitetet në grup- moshë	Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)	Takime me prindër	Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve	Konsulta me edukatore e stafit / mësimdhënë udhëtues të Qendrave Burimore si dhe prindër	Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve	Tjera
E hënë Koha:								
E martë Koha:								
E mërkurë Koha:								
E enjte Koha:								
E premte Koha:								

Nënshkrimi i edukatores mbështetëse _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Raporti javor i punës së edukatores mbështetëse

Emri dhe mbiemri i edukatores mbështetëse _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Aktivitetet e realizuara	Aktivitetet e perealizuara	Vërejtje/Komente
Puna në zyre – Përgatitja e materialeve			
Aktivitetet dhe bashkëaktivite-tet në grup- moshë			
Hartimi/rishiki mi i planit individual të arsimit (PIA).			
Takime me prinder			
Konsulta me edukatoren e stafit / mësimdhënësit udhëtues të Qendrave Burimore si dhe prindër			
Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve			
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve			
Të tjera			

Nënshkrimi i edukatores mbështetëse _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Plani mujor i punës së edukatores mbështetëse

Emri dhe mbiemri i edukatores mbështetëse _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Java I	Java II	Java III
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve			
Aktivitetet/bashkë aktivitetet individuale dhe në grup-mosha			
Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)			
Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve			
Puna në zyrë – Përgatitja e materialeve			
Konsultime me edukatorët e stafit/ mësuesit udhëtues të Qendrave Burimore si dhe prindër			
Koordinimi me drejtorin, stafin e institucionit dhe komunitetin për krijimin e kulturës gjatëpërfshirëse			
Të tjera			

Nënshkrimi i edukatores mbështetëse _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Raporti mujor i punës së edukatores mbështetëse

Emri dhe mbiemri i edukatores mbështetëse _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Fëmija/nxënësi/ orët	Fëmija/ nxënësi/ orët	Fëmija/ nxënësi/ orët	Fëmija/ nxënësi/ orët	Fëmija/ nxënësi/ orët
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të veçanta arsimore të fëmijëve					
Aktivitetet/bashkë aktivitetet individuale dhe në grup- moshë					
Hartimi/ rishikimi i planit individual i arsimit (PIA)					
Puna individuale me fëmijë/me grup të vogël të fëmijëve					
Puna në zyrë – Përgatitja e materialeve					
Konsultime me edukatoret e stafit, prindër					
Konsultime me edukatoret e stafit/ mësuesit udhëues të Qendrave Burimore si dhe prindër					
Koordinimi me drejtorin, stafin e institucionit dhe komunitetin për krijimin e kulturës gjithëpërfshirëse					
Tjera					

Nënshkrimi i edukatores mbështetëse _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Plani javor i punës së Asistentit për fëmijë me nevoja të veçanta

Emri dhe mbiemri i asistentit _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
Lënda/fusha e aktiviteve					
Mbështetja e ofruar për nxënësin në klasë					
Në bashkëpunim me mësimdhësinin bën përgatitjen e materialeve mësimore duke u bazuar në PIA					
Aktivitetet plotësuese					

Nënshkrimi i asistentit _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Raporti javor i punës së asistentit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore

Emri dhe mbiemri i asistentit _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Aktivitete e realizuara	Aktivitetet e parealizuara	Vërejtje/komente
Lënda/fusha e aktiviteteve			
Mbështetja e ofruar për nxënësin në klasë			
Në bashkëpunim me mësimpldhënësin bën përgatitjen e materialeve mësimore duke u bazuar në PIA			
Përmbledhja e aktiviteteve			
Komente			

Nënshkrimi i asistentit _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Plani mujor i asistentit për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta

Emri dhe mbiemri i asistentit _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Java I	Java II	Java III	Java IV	Java V
Lënda/fusha e aktiviteve					
Mbështetja e ofruar për nxënësin në klasë					
Në bashkëpunim me mësimdhënësin bën përgatitjen e materialeve mësimore duke u bazuar në PIA					
Përmbledhja e aktiviteve					
Komente					

Nënshkrimi i asistentit _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

Raporti mujor i asistentit për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore

Emri dhe mbiemri i asistentit _____

Emri i institucionit _____

Viti shkollor _____

Data: _____

Aktivitetet	Java I	Java II	Java III	Java IV	Java V	Progresi (zhvillimi) i nxënësit.
Lënda/fusha e aktiviteteve						
Mbështetja e ofruar për nxënësin në klasë						
Në bashkëpunim me mësime/nxënësin bën përgatitjen e materialeve mësimore duke u bazuar në PIA						
Përmbledhja e aktiviteteve						
Komente						

Nënshkrimi i asistentit _____

Nënshkrimi i drejtorit: _____

DEKLARATË E PRINDIT/KUJDESTARIT TË FËMIJËS

Kjo deklaratë duhet të lexohet nga prindi/kujdestari i fëmijës dhe për çështjet që pajtohet ose nuk pajtohet duhet ta vendosë simbolin X në katrorin □ për deklarimin përkatës. Në fund, deklarata duhet të nënshkruhet nga prindi/kujdestari i fëmijës, të cilit duhet t'i jepet një kopje e kësaj deklaratë.

Unë _____, i lindur me _____, me nr. personal _____,
(Emri dhe mbiemri i prindit) (Data e lindjes) (Numri i letërnjoftimit)

prindi/kujdestari i fëmijës _____, deklaroj si në vijim:
(Emri dhe mbiemri i fëmijës)

- PAJTOHEM** që fëmija im të ketë mbështetje profesionale: *Mësimdhënësi mbështetës/Asistent.*
- NUK PAJTOHEM** që fëmija im të ketë mbështetje profesionale: *Mësimdhënësi mbështetës /Asistent.*
- PAJTOHEM** që fëmija im të fotografohet gjatë zhvillimit të aktiviteteve nga *Mësimdhënësi mbështetës/Asistenti* për nevoja të shkollës.
- NUK PAJTOHEM** që fëmija im të fotografohet gjatë zhvillimit të aktiviteteve nga *Mësimdhënësi mbështetës/Asistenti* për nevoja të shkollës.
- PAJTOHEM** që fëmija im të ketë audio incizim nga *Mësimdhënësi mbështetës/Asistenti* për nevoja të shkollës.
- NUK PAJTOHEM** që fëmija im të ketë audio incizim nga *Mësimdhënësi mbështetës/Asistenti* për nevoja të shkollës.
- PAJTOHEM** që çdo material që e krijon fëmija im gjatë procesit mësimor mund të përdoret nga *Mësimdhënësi mbështetës/Asistenti* për qëllime hulumtimi/ kërkimi në raporte, seminare, konferenca, etj.
- NUK PAJTOHEM** që çdo material që e krijon fëmija im gjatë procesit mësimor mund të përdoret nga *Mësimdhënësi mbështetës/Asistenti* për qëllime hulumtimi/ kërkimi në raporte, seminare, konferenca, etj.

E kam lexuar dhe kuptuar tërë përmbajtjen që është shkruar më lartë.

Data: _____

Nënshkrimi: _____
(Nënshkrimi i prindit/kujdestarit të fëmijës)

Grupi punues për hartimin e materialit ndihmës për punën e mësimeve mbështetës, edukatorit mbështetës si dhe asistentit për fëmijë/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

- 1.Besmira Thaqi-Bahtiri: kryesuese e grupit,
- 2.Elhame Llapashtica: anëtare,
- 3.Naime Reçica-anëtare,
- 4.Refik Azemi, DKA Mitrovicë- anëtar,
- 5.Arben Zabeli, DKA Skënderaj- anëtar,
- 6.Doruntina Asllani, DKA Ferizaj- anëtare,
- 7.Nermin Emini, QB “Nëna Terezë” Mitrovicë- anëtare,
- 8.Dafina Ademi, QB “Përparimi” Prishtinë- anëtare,
- 9.Remzije Osmani sh.f.m.u “Ahmet Delija” Skënderaj- anëtare
- 10.Remzije Hoxha sh.f.m.u “Kongresi i Manastirit” Podujevë- anëtare.

